



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT

Nr. 462 Prot.

Himarë më 15/02/2019

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË  
NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUES**

**Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e  
Panifikimit & Zhvillimit të Territorit, Bashkia Himarë – Kategoria e  
pagës III-a**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Himarë** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**1. Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Panifikimit  
& Zhvillimit të Territorit, Kategoria e pagës III-a**

*Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Të dyja këto procedura është vendosur të jenë të hapura edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të nenit 26/4).*

**Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)**

**aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 25.02.2019**

**LËVIZJE PARALELE**

**Afati për dorëzimin e Dokumenteve: 02.03.2019**

**NGRITJE NË DETYRË**

## Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- ✓ Organizon dhe drejton punën brenda zyrës, raporton dhe përgjigjet direkt tek drejtori i Drejtorisë dhe Kryetari Bashkisë.
- ✓ Përgjigjet për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë në zyrë.
- ✓ Organizon punën për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me PPV instrumentat e zhvillimit të territorit bazuar në ligjin “Për Planifikimin e Territorit”, duke u mbështetur në dokumentacionin topografik nga Kadastra Urbane dhe specialisti i GIS mbi hartat dhe kufijtë administrative të njësisë vendore të paraqitura në sistemin e gjeoreferimit të përcaktuara, hartimin e politikave vendore të zhvillimit të territorit, në pasqyrimin e përparësive, qëllimet strategjike dhe objektivat e njësisë vendore.
- ✓ Drejton punën në zyrë për hartimin e detyrave së projektimit, me ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt-preventivave sipas urdhërave të Kryetarit të Bashkisë në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Drejton punën në zyrë për detyrat e zyrës në hartimin e instrumentave vendore të planifikimit të territorit (PPV,PDV etj ).
- ✓ Merr pjesë në hartimin e politikave vendore të zhvillimit të territorit, në pasqyrimin e përparësive, qëllimet strategjike dhe objektivat e njësisë vendore.
- ✓ Përgatit materialit për dërgimin e PDV-ve së bashku me relacionin shpjegues në mbështetje të nenit 57 të “Rregullores së Planifikimit të territorit”.
- ✓ Jep prononcim e vet me shkrim në lidhje me përputhshmërinë e Planeve të detajuara dhe planvendosjeve të kërkesave për leje zhvillimi me Planin e Përgjithshëm Vendor.
- ✓ Organizon punën pas miratimit të PDV dhe lejeve të zhvillimit së bashku me Specialistin për planifikimin e territorit, hartimit dhe kontrollit të PDV për përditësimin dhe përgatitjen e hartave topografike të hedhin në hartë në bashkëpunim me kadastrën urbane objektet e reja në vijën administrative të njësisë vendore.
- ✓ Përgatit materialet në bashkëpunim me projektuesin e kontraktuar, kur ka të tillë, për hartimin e planit të përgjithshëm vendor të njësisë vendore.
- ✓ Organizon punën për kontrollin e kërkesave për leje ndërtimi.
- ✓ Organizon punën për studime dhe hartimin e projekteve sipas kërkesës së Institucionit.
- ✓ Organizon punën për kontrollin e projekteve që vijnë në Bashki.
- ✓ Organizon punën për mobilim të zonave të veçanta Urbane sipas nevojës së Bashkisë

## I LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Inxhinierike, Arkitekturë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

*Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 25.02.2019.*

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **27.02.2019** Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit e Bashkisë Himarë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit e Bashkisë Himarë, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave".
- e) Njohuritë mbi ligjin Nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".
- f) Njohuritë mbi ligjin Nr. 73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".
- g) Njohuritë mbi ligjin Nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"
- h) Njohuritë mbi VKM Nr. 671, datë 21.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit.
- i) Njohuritë mbi Udhëzim Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores për Zhvillimin e Territorit"
- j) Njohuritë mbi Udhëzimeve dhe akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të mësipërme.

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike

1.6

## DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në standën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2

## NGRITJA NË DETYRË

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë,*

*Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik, neni 26/4).*

2.1

## KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Inxhinierike, Arkitekturë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë punë jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

## 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

*Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 02.03.2019.*

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **08.03.2019** Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit e Bashkisë Himarë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit e Bashkisë Himarë, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## 2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- e) Njohuritë mbi ligjin Nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

- f) Njohuritë mbi ligjin Nr. 73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".
- g) Njohuritë mbi ligjin Nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"
- h) Njohuritë mbi VKM Nr. 671, datë 21.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit.
- i) Njohuritë mbi Udhëzim Nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores për Zhvillimin e Territorit"
- j) Njohuritë mbi Udhëzimeve dhe akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të mësipërme.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al). <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

**2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në standën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit

BASHKIA HIMARË

